



**ENTI RREGULLATOR I ENERGISË  
BORDI**

**VENDIM**

*Nr. 156 Datë 28.09.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË  
LLOGARITJES SË TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË  
SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20 gërma a; nenit 108 numër 3 dhe nenit 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 21, 22 dhe 26 të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin nr. 96 datë. 17 .06. 2016; VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për miratimin e “draft–Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

Konstatoi se,

- Në përmbushje të këtij detyrimi drejtoritë teknike në bashkëpunim me konsulencën e USAID kanë përgatitur draft metodologjinë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Drafti i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, mbështetet në parimin “price cap” i njëjtë me metodologjinë egzistuese të llogaritjes së tarifës (Vendimin nr. 79, date 26 Qershor 2008, të Bordit të Komisionereve të ERE-s), me disa ndryshime sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”.
- Ndryshimet e propozuara mbështeten në praktikën dhe eksperiencat e deritanishme të miratimit dhe rishikimit të tarifave pa ndryshuar thelbin e metodologjisë ekzistuese, por përmban ndryshime teknike në lidhje me kërkesat për komponentët përbërës të tarifës nisur nga praktika dhe eksperiencia e deritanishme.
- Kjo metodologji citon nevojën e hartimit të formateve standarte të aplikimit, si për tarifën e aksesit po ashtu dhe të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes nga FSHU.
- Për përcaktimin e të ardhurave të kërkuara në vitin bazë të periudhës së ardhshme rregullatore, në nenin 7 pika 2 është propozuar që: elementeve që figurojnë në metodologjinë aktuale dhe merren në konsideratë për të bërë rregullime/axhustime në

të ardhurat e vitit të testimit, t'u shtohet edhe elementi “të ardhura të tjera”. Kjo nënkupton që, përveç sa përmenden në metodologjinë aktuale ERE do të kryejë axhustime edhe për të ardhurat e tjera si:

- a. të ardhurat nga lidhjet e reja;
  - b. energjia reaktive;
  - c. çdo e ardhur tjetër kur kjo nuk është e pasqyruar në aplikim.
- Hartimi i planeve të investimeve sa më reale e të realizueshme, nëpërmjet mekanizmit të axhustimit të të ardhurave të kërkuara parashikohet që ERE të rishikojë/ të korrigjojë tarifat, në rast se OSSH dështon në zbatimin e planit të investimeve.
  - Kjo metodologji, vendos domosdoshmërinë e alokimit të kostove të energjisë dhe kapacitetit sipas niveleve të tensionit, për të mundësuar përcaktimin e një tarife sa më të drejtë për të mundësuar aksesin e klienteve fundore në rrjetin e shpërndarjes
  - Është kryer perditësimi i termave të përdorur në metodologji konform përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
  - Për energjinë elektrike të përdorur nga klientët të cilët, pikën e lëvrimit të energjisë elektrike e kanë të ndryshme nga pika e matjes, është parashikuar që në rrillogaritjen e tarifës për këtë kategori klientësh të përfshihet humbja që ata shkaktojnë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

- 1 Fillimin e procedurave për miratimin e metodologjise së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- 2 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë te interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**